



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E PUNËVE TË JASHTME
DREJTORIA E AUDITIMIT TË BRENDSHËM

PLANI STRATEGJIK I DREJTORISË SË AUDITIMIT TË BRENDSHËM NË MINISTRINË E PUNËVE TË JASHTME PËR PERIUDHËN 2016 – 2020.

Në zbatim të Ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, ndryshuar me ligjin nr. 10318, datë 16.09.2010 si dhe aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji, Drejtoria e Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme ka hartuar planin strategjik 2016-2020 dhe planin vjetor për vitin 2016, për veprimtarinë e auditimit të brendshëm, si strukturë audituese e brendshme e Ministrisë së Punëve të Jashtme.

A. Baza Ligjore :

Neni 18 pika 2, e ligjit nr. 9720, datë 23.04.2007 “Për Auditimin e Brendshëm në Sektorin Publik”, ndryshuar me ligjin nr. 10318, datë 16.09.2010 si dhe aktet nënligjore në zbatim të këtij ligji.

B. Periudha e planifikuar :

Janar 2016 – Dhjetor 2020

C. Struktura përgjegjëse :

Drejtoria e Auditimit të Brendshëm

D. Struktura kontrolluese :

Ministri i Punëve të Jashtme, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Kontrolluese/ Njësia Qendrore e Harmonizimit për Auditimin e Brendshëm në Ministrinë e Financave.

E. Përshkrimi i aktivitetit :

Për hartimin e këtij plani u patën parasysh :

- Objektivat e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, si dhe përshkrimi i veprimtarive të kërkuara për arritjen e këtyre objektiveve.
- Hapësirat e veprimit të planifikuara dhe përparësitë në të cilat auditimi i brendshëm duhet të fokusohet.
- Frekuenca e auditimeve, parashikimi i zonave me rrisht më të lartë.
- Llogaritja e burimeve të kërkuara për auditimin e brendshëm
- Plani i zhvillimit profesional për audituesit dhe trajnimet shtesë
- Kufizimet e mundshme të qëllimit të auditimit

Objektivat e auditimeve të brendshme, përshkrimi i veprimeve për arritjen e këtyre objektiveve :

Hartimi i planit strategjik për auditimin e brendshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe të subjekteve që janë në vartësi të saj për periudhën 2016 -2020 është mbështetur në objektivat e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, të cilat janë:

1. Dhënia në mënyrë të pavarur e sistematike të një sigurie të arsyeshme për titullarin e Ministrisë së Punëve të Jashtme, për të përmirësuar veprimtarinë e subjektit publik dhe frytshmërinë e sistemeve të kontrollit të brendshëm.
2. Shqyrtimi, vlerësimi dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm dhe transaksionet lidhur me :
 - a. Rrisqet e brendshme të kontrollit të drejtimit.
 - b. Përdorimin me kursim, dobi dhe frytshmëri të burimeve financiare dhe njerëzore, të identifikojë fusha ku performanca e veprimeve mund të përmirësohet dhe të rekomandojë zgjidhje për dobësitë e sistemit të kontrollit.
 - c. Shkallën në të cilën rezultatet e programeve të subjektit të audituar plotësojnë objektivat e tij.
 - d. Pajtueshmërinë e veprimtarisë së subjektit të audituar me legjislacionin në fuqi.
 - e. Të shqyrtojë rregullat e ruajtjes së aseteve dhe sipas rastit të verifikojë ekzistencën e tyre.

Për arritjen e këtyre objektivave për çdo vit hartohen dhe realizohen planet vjetore të punës së auditimit, të cilat do të mbështeten në vlerësimin e rrishtit, flukset e punës, ecurinë e objektivave, etj. Në përfundim të auditimeve të kryera, audituesit do të vlerësojnë nëse objektivat e mësipërme janë arritur ose e kundërta. Pra, i gjithë procesi i kryerjes së një auditimi, në përfundim finalizohet me përcaktimin e arritjes së objektivave të mësipërme.

Funksionimi i kësaj Drejtorie në vitet e fundit, në 4 + 1 ndikon drejtpërsëdrejti në rritjen e frekuencës së auditimeve nga 1 herë në 5-6 vite në një herë në 3-4 vite. Rritja e frekuencës së auditimeve dhe ulja e kohës nga njëri auditim tek tjetri do të ndikojë ndjeshëm në cilësi duke rregulluar në kohë sistemet e kontrollit që kanë nevojë për përmirësim.

Përveç auditimeve të plota, nga Drejtoria e Auditimit të Brendshëm do të kryhen edhe një sërë auditimesh tematike dhe verifikim detyrash, duke marrë në konsideratë tematika të veçanta të cilat kanë risk të lartë dhe plotësimin me informacion të Ministrisë në rastet e kërkuara.

• ***Hapësirat e veprimtarive të planifikuara dhe përparësitë ku do të fokusohet auditimi gjatë periudhës së planifikuar :***

Për periudhën 5-vjeçare, auditimi në sistemin e Ministrisë së Punëve të Jashtme do të fokusohet në mbulimin me auditim të gjithë subjekteve të varësisë, gjë e cila do të realizohet në përputhje me afatet e miratuara sipas Urdhërit të Ministrisë të Financave nr. 69, datë 29.09.2010 “Për miratimin e manualit të procedurave të auditimit të brendshëm”.

Për kryerjen e auditimit do të merren parasysh fondet buxhetore që kanë në përdorim subjektet e audituara, fushat e veprimtarisë së këtyre subjekteve, rrishtin që mbulojnë këto subjekte, numrin e punonjësve të subjekteve, vlerësimin nga auditimi i mëparshëm, etj.

Përparësitë ku do të fokusohet auditimi do të jenë sipas rezultateve të vlerësimit rriskut duke filluar nga rrisku më i lartë deri tek rrisku më i ulët. Mbi bazën e këtij vlerësimi të rriskut përparësitë në auditim do të jenë :

1. Planifikimi dhe programimi i fondeve buxhetore dhe shkalla e vendim marrjes për to.
2. Rregullshmëria e përdorimit të burimeve financiare dhe zbatimi i procedurave të investimeve.
3. Mirëadministrimi i vlerave materiale dhe respektimi i normave të përdorimit të tyre.
4. Përmirësimi i rregullave dhe sistemeve të kontrollit të brendshëm me qëllim menaxhimin sa më të mirë të aseteve dhe burimeve për arritjen e objektivave nga subjekti i audituar.

- ***Frekuenca e auditimit dhe rradhitja e zonave të auditimit***

Realizimi i programit 5-vjecar është i lidhur me disa faktorë të jashtëm dhe të brendshëm :

Faktorët e jashtëm :

1. Ndryshimet në legjislacion.
2. Ndryshimet në nivelin e menaxhimit të lartë dhe të mesëm
3. Mungesa e profesionalizmit të personave të ngarkuar me financën.
4. Organizimi dhe funksionimi i njësisë së auditimit.

Faktorët e brendshëm :

1. Burimet e pamjaftueshme materiale, financiare dhe njerëzore në dispozicion.
2. Mbështetja e pamjaftueshme nga menaxhimi.
3. Ndryshimi i numrit numrit të subjekteve për auditim.

Duke ju referuar këtyre faktorëve, plani i auditimit për 5 vitet e ardhshme është hartuar me qëllim mbulimin me auditim të gjithë subjekteve të varësisë për të ulur frekuencën e auditimit nga mesatarisht 5-6 vite që është aktualisht në 3-4 vite. Nga planifikimi i kërkuar supozohet që shmangia nga plani i auditimit të jetë 3 deri 4 subjekte në vit, e cila mund të zëvendësohet nga menaxhimi me ndonjë plan tjetër auditimi.

- ***Llogaritja e burimeve të kërkuara për auditimin e brendshëm***

Struktura e Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm është aktualisht 4+1, gjë që bën të mundur mbulimin me auditim të gjithë subjekteve të varësisë së MPJ-së për një periudhë 2 -3 vjeçare dhe garantohet cilësia në kryerjen e auditimeve. Mesatarisht duke llogaritur edhe trajnimet për secilin auditues dhe duke hequr edhe ditët e festave zyrtare, rezulton që një auditues të kryejë 206 ditë pune.

Problem aktualisht mbetet numri i pakët i ditëve të planifikuara për kryerjen e auditimit në subjektin e audituar për shkak të kostove që mbart kryerja e një misioni auditimi. Janë llogaritur mesatarisht shpenzimet për paga, dieta dhe bileta udhëtimi.

- ***Plani i zhvillimit profesional të audituesve***

Për zhvillimin profesional të audituesve për periudhën 5-vjecare, do të zhvillohen tema trajnimi sipas programit vjetor dhe në kuadër të bashkëpunimit me Njësine Qëndrore të Harmonizimit për auditimin e brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Shkollën shqiptare për Administratën Publike.“ Në këtë proces trajnimi do të përfshihen gjithashtu edhe publikimet e ndryshme të Njesisë Qëndrore të Harmonizimit për auditimin e brendshëm, buletinet e dërguara nga KLSH, literaturë e gjendur nëpërmjet internetit dhe materiale të siguruar nëpër seminare të ndryshme.

Duke vlerësuar bashkëpunimin tonë të vazhdueshëm me Njësine Qëndrore të Harmonizimit për auditimin e brendshëm në Ministrinë e Financave mbi kualifikimin e audituesve, mendojmë që ky bashkëpunim të intensifikohet më tej. Kjo njësi duhet të planifikojë trajnime të mëtejshme për audituesit, veçanërisht trajnime të drejtimit praktik, sipas standarteve, duke marrë në konsideratë edhe faktin se në strukturat e auditimit kanë filluar edhe punonjës të rinj të cilët akoma nuk janë familjarizuar me konceptin e ri të procesit të auditimit dhe rolit të tij.

- ***Kufizime të mundshme në arritjen e qëllimeve dhe objektivave të auditimit***

Për të mos arritur qëllimin dhe objektivat e auditimit mund të ndikojnë disa faktorë të cilat janë :

1. Ndryshimet strukturore të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm
2. Lëvizja e punonjësve të Auditimit të Brendshëm
3. Mbështetja materiale dhe motivimi në punë i punonjësve të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm.

Plani vjetor 2016 i ndarë në 6 mujorë (Format i nr.2)

Në hartimin e planit vjetor të punës janë mbajtur parasysh kriteret e mëposhtme:

- Afati i gjatë i mos ushtrimit të auditimeve në Përfaqësitë Diplomatike e Konsullore.
- Transferimi i personelit të Përfaqësisë, sidomos i atij personeli që ka përgjegjësi monetare dhe materiale (titullari i Përfaqësisë, i ngarkuari me financën, etj)
- Përfaqësitë që kanë aktivitet të dendur ekonomik-financiar dhe konsullor.
- Mundësia për të audituar dy Përfaqësi brenda një udhëtimi me qëllim shkurtimin e kohës së auditimit dhe shpenzimeve.
- Shfrytëzimi maksimal i kohës së auditimit nëpër Përfaqësi, me qëllim reduktimin e shpenzimeve për ditë qëndrimi në vendet përkatëse.
- Tematika të ndryshme që përcaktohen nga menaxhimi.

Objektivat e auditimit të brendshëm në Ministrinë e Punëve të Jashtme

- Sigurimi i menaxhimit të Ministrisë së Punëve të Jashtme për zbatimin e procedurave aktuale në lidhje me sistemin e kontrollit të brendshëm që aktualisht zbatohet në institucionin tonë dhe në subjektet vartëse.
- Përmirësimi i veprimtarisë së MPJ dhe të subjekteve të vartësisë me anë të rekomandimeve që do të jepen për përmirësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në lidhje me kontrollin e drejtimit, të performancës dhe të vlerësimit.
- Sigurimi i menaxhimit të lartë për përdorimin me efektivitet dhe efikasitet të burimeve financiare dhe njerëzore.

- Vlerësimi i programeve financiare, të performancës, vlerësimi dhe të drejtimit në lidhje me objektivat e vëna nga menaxhimi i institucionit.

Përshkrimi i veprimtarive për arritjen e objektivave :

- Marrja e informacionit në lidhje me veprimtarinë e njësive që do të auditohen si në aparatin e MPJ-së ashtu edhe në subjektet e vartësisë.
- Përpunimi i informacionit të marrë paraprakisht dhe përgatitja e programeve të auditimit të subjekteve dhe aktiviteteve që do të auditohen.
- Proçesi i auditimit të aktiviteteve të vlerësuara më parë për auditim.
- Vlerësimi i veprimtarisë së subjekteve dhe sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim përmirësimin e këtij sistemi dhe këtyre praktikave, për të shmangur rrisqet e mundshme në lidhje me arritjen e objektivave.
- Hartimi i projekt raporteve dhe raporteve finale.
- Dhënia e rekomandimeve të vlerësuara si të dobishme në përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm dhe kërkesa për zbatimin e tyre.

Specifikimi i problemeve për realizimin e programit të auditimit :

- Mungesa e njohurive profesionale të personelit që auditohet.
- Strukturat jo adekuate në këndvështrimin e funksionimit të sistemit të kontrollit të brendshëm që kërkohet të implementohet dhe të zbatohet;
- Kufizimet buxhetore dhe në personel;
- Papërshtatshmëria e plotë ligjore në lidhje me fushën e auditimit dhe në kuptimin e “auditimit” nga strukturat dhe personeli që auditohet si një fushë e rëndësishme në ndihmë të nivelit menaxhues;
- Largësia fizike e subjekteve që auditohen, e cila përbën një pengesë të konsiderueshme në drejtim të funksionimit normal të sistemit që kërkohet të implementohet.

Vlerësimi i rrishtit :Për të bërë analizën e rrishtit gjithë e parë që duhet të përcaktojë audituesi janë faktorët që ndikojnë në funksionimin e sistemit si dhe të përcaktojë shkallën e ndikimit të tyre në përmbushje të objektivave me anë të pikëve sipas hapave të mëposhtëm:

- Vlerësimi dhe identifikimi i rrishtit në fushën e menaxhimit financiar,
- Identifikimi i rrishtit në fushën e vlerësimi të performancës dhe të drejtimit,
- Vlerësimi i zbatimit të procedurave dhe rrishtit në lidhje me moszbatimin e tyre.
- Përcaktimi i pikave kontrolluese dhe mekanizmave për shmangien dhe minimizimin e ndikimit të tij në përmbushjen e objektivave dhe mbrojtjen e aseteve.

Prioritetet e punës së njësive të auditimit:

Zbatimi i detyrave të lëna nga auditimi i fundit, vlerësimi i sistemit të kontabilitetit dhe ligjshmëria e dokumentit financiar, kontrolli mbi fondin e investimeve, kontrolli mbi përdorimin e fondit “pritje përcjellje”, kontrolli i pagave, kontrolli i fondit “qera”, kontrolli i të ardhurave konsullore, shpenzimet për karburant dhe shpenzimet për automjete.

Burimet për auditimin e brendshëm :

Burimet e auditimit të brendshëm janë burimet njerëzore dhe burime materiale. Burimet njerëzore klasifikohen në burime të brendshme dhe burime të jashtme.

- Burimet e brendshme janë kapacitetet njerëzore dhe profesionale të cilat njësia e auditimit i ka në dispozicion të përhershëm
- Burimet e jashtme janë personel i aktivizuar në auditim nga struktura të tjera brenda MPJ-së.
- Burimet materiale janë kapacitetet financiare dhe materiale për kryerjen e misioneve të auditimit.

Plani i kufizuar për të përmbushur ato detyra që rrjedhin nga drejtimi i institucionit :

Ndjekja e problemeve të veçanta me urdhër të titullarit ose të dala gjatë procesit të auditimit(auditimi tematik).

Zonat me rrisht të lartë :

1. Fusha e të ardhurave konsulllore.
2. Ligjshmëria e kontratave të qerave.
3. Orizinaliteti i faturave.

Frekuenca e auditimeve :

Kryerja e auditimeve bëhet mbështetur në planin vjetor që drejtoria jonë harton. Frekuencat e auditimit realizohen në bazë të një plani, i cili hartohet për periudhën 6 mujore dhe 1 vjeçare (duke u mbështetur në vlersimin e rrishtit, fluksin e punës dhe realizimin e objektivave). Duke marrë parasysh problematikën e secilës njësi auditimi, rrishtet e subjektivit në procesin e realizimit të objektivave si dhe për të shmangur rrishtet që vijnë nga mos kryerja e auditimeve përcaktohet një raport optimal midis këtyre faktorëve dhe frekuencës së auditimeve.

Mbështetur në praktikat e vitit 2014 dhe 2015, realizohen mesatarisht dy auditime në muaj, duke ulur frekuencën e auditimit nga 5-6 vite mesatarisht në 3-4 vite. Edhe gjatë vitit 2016 frekuenca e auditimeve do të jetë e shpeshtë me qëllim auditimin në një kohë sa më të shpejtë të atyre subjektivave të cilave u ka kaluar ndjeshëm afati i auditimit. Numri i ditëve të misionit të auditimit varion nga 3-6 ditë në varësi të kohës së paaudituar të njësisë si dhe numrit të veprimeve financiare që duhet të auditohen.

Përmirësimi i kapaciteteve audituese :

Përmirësimi i kapaciteteve audituese bëhet nëpërmjet trajnimeve të ndryshme.

1. Trajnime të organizuara në MPJ
2. Trajnime të organizuara nga Ministria e Financave
3. Trajnime të organizuara nga ASPA

Rrishtet e brendshme në kuadër të planit të auditimit

1. Mungesa e njohurive për auditimin.
2. Mungesa e fondeve buxhetore.
3. Konflikti i interesave mes të audituarve dhe audituesve.